



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2125/Prot.
21

Tiranë, më 01.08 2025

VENDIM

Nr.231, Datë 25.07.2025

**“PËR EMËRIMIN SI MAGJISTRAT TË KANDIDATIT PËR PROKUROR, TË
DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, NË VITIN AKADEMIK
2024-2025, Z. ROLAND PAJA”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 25.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për emërimin si magjistrat të kandidatit për prokuror, të diplomuar në Shkollën e
Magjistraturës, në vitin akademik 2024-2025, z. Roland Paja”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2125, datë 24.06.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi dëgjoi Relatorin Ledina Riza, si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim, Këshilli)* garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve.
2. Përmes Shkresës nr. 936, datë 09.07.2025, “Mbi klasifikimin e kandidatëve për magjistratë, profili Prokuror, të cilët përfunduar programin 3-vjeçar të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës”, të Shkollës së Magjistraturës drejtuar Këshillit, është dërguar lista emërore me klasifikimin e kandidatëve për magjistratë, profili Prokuror, ndër të cilët edhe kandidati Roland Paja.
3. Në këtë listë jepen të dhëna, ndër të tjera, për pikët totale dhe nivelin e vlerësimit për secilin prej tyre duke bërë njëkohësisht edhe renditjen sipas këtyre rezultateve sipas numrit rendor në këtë tabelë.
4. Në nenin 148/ç, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.”

5. Po ashtu, në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;....

6. Ndërsa, në nenin 35, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;

b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

.....

4. Brenda afatit njëmuor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat:

a) emërojnë magistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, ose refuzojnë të emërojnë magistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, por që nuk përmbush kriteret e emërimit.”

7. Sa më sipër, të gjithë kandidatët për magistratë, profili Prokuror të listuar janë diplomuar në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2024-2025, kanë plotësuar kriteret e mësipërme ligjore.

8. Në nenin 184, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështjet e mëposhtme, në lidhje me të gjithë prokurorët:

a) emërimin;

..... ”

9. Po ashtu, në nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit të mësipërm, përcaktohet se:

“1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr aktet e mëposhtme:

a) *akte administrative individuale, në lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore;...*”

10. Përsa më sipër, Këshilli duhet të vijojë me procedurën ligjore të emërimit si magistratë të kandidatëve për prokurorë, të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2024-2025, sipas listës emërore të sjellë nga Shkolla e Magjistraturës, ndër të cilët edhe kandidati Roland Paja.

11. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit emërimin si magistrat të kandidates për prokuror, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2024-2025, z. Roland Paja.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 148/ç, pika 1, 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 35, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 184, germa “a”, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të emërojë si magjistrat kandidatin për prokuror, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2024-2025, z. Roland Paja.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm dhe z. Roland Paja.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 25.07.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda